



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 1620 Prot.

VauDejes me/0 103/2021

NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e Qytetit Vau Dejës, Bashkia Vau Dejes, të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e mëposhtem:

“Dhënien në përdorim të pasurisë nr.1/54 dhe 1/471 (Pjese), Zk Nr.8598, e llojit (Ndertese + Truall) me sipërfaqe totale 572 m2, nga kjo, Ndërtesë 165.5 m2, dhe sipërfaqe funksionale përreth objektit 406.5 m2, në Qytetin Vau Dejës”.

Dëgjesa publike do të bëhet me datë 07.04.2021 ora 11.00 në Qytetin Vau Dejes, Bashkia Vau Dejes, duke respektuar masat anti Covid (takim jo më shumë se 10 persona).

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjesës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

(info@vaudejes.gov.al , ardian.celepija@vaudejes.gov.al , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës).

SEKRETARI KËSHILLIT

Ardian CELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETEVE**

Nr 1541 Prot.

Vau Dejës me 08/03 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

Z. Mark Bisha

KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK VAU DEJES

I nderuar z. Kryetar

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt Propozimin:

“Për dhënie në përdorim të pasurisë Nr 1/54 dhe 1/471 (Pjese), Zk nr 8598, e llojit Ndërtesë +Truall, me sipërfaqe të përgjithshme 572 m², nga kjo, Ndërtesë 165.5 m², dhe sipërfaqe funksionale prej 406,5 m², ndodhur në Qytetin Vau Dejës.

Me respekt,

NE MUNGESË DHE ME URDHER

ZV/KRYETARI

LESTINË NDOJA



**KRYETARI
MARK BABANI**

Miratoi:

Kristi Bajo: Drejtor i Drejtorisë Juridike Prokurimeve dhe Integrimit

Konceptoi:

Ndoc Baqli: Përgjegjës i Sektorit të Aseteve

Datë: 08.03.2021

Nr faqeve A4 të projekt-propozimit 1

Nr faqeve A4 të dokumenteve që shoqërojnë projekt-propozimin 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES
DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE INTEGRIMIT
SEKTORI I ASETETEVE**

Projekt – Propozim

Nr 01. Datë.05.03.2021

Për dhënien në përdorim të pasurisë nr 1/54, dhe 1/471 (Pjese), Zk Nr 8598, e llojit (Ndërtesë+Truall) me sipërfaqe totale 572 m2, nga kjo, Ndërtesë 165.5 m2, dhe sipërfaqe funksionale përreth objektit 406.5 m2, në Qytetin Vau Dejës.

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 4, ligji nr 38/2019, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, ndryshuar. Në VKM nr. 1423 dt 10.10.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës, të Qarkut të Shkodrës”, në VKM nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI :

1. Miratimin e dhënies me qira me afat deri ne 10 vjet, të pasurisë nr 1/54 dhe 1/471(Pjese),e llojit Ndërtesë+Truall, Zk 8598, Qyteti Vau Dejës, me sipërfaqe të përgjithshme 572 m2, nga kjo; Ndërtesë 165.5 m2, dhe sipërfaqe funksionale perreth objektit, 406,5 m2. Në objekt mund të ushtrohet veprimtari në fushen e artizanatit, qëndistari, punë me dorë, tezgjah etj..
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen në investime publike.
3. Vlera dysheme e qirasë mujore të jetë sipas raportit teknik bashkëlidhur, sipas VKM-së nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

**KRYETARI
MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/ KRYETARI
LESTINË NDOJA**



Konceptoi: Armand Filipi

Miratoi: P/sek. Ndoc Baqli

RAPORT TEKNIK


MBI LLOGARITJEN E SIPËRFAQES DHE VLERËN DYSHEME TË QIRASË SË PASURISË Nr 1/54 dhe 1/471 ZK NR 8598, TË LLOJIT NDËRTESE + TRUALL, NË QYTETIN VAU DEJES.

Bazuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë me nr 80 dt 01.03.2021, grupi i punës realizoi verifikimin e gjendjes faktike të pronës dhe matjet e sakta në terren, duke përcaktuar gjendjen funksionale të objektit, sipërfaqen e saktë të pasurisë Ndërtese + Truall, veprimtarinë që mund të ushtrohet, dhe llogaritjen e vlerës së qirasë, ku nga verifikimi dhe llogaritjet rezultoi se:

- Pasuria Nr 1/54 Zk 8598, e llojit ndërtesë është në gjendje të mirë teknike, e pasqyruar kjo edhe në relacionin dërguar Kryetarit të Bashkisë. Ka një sipërfaqe prej 165.5 m², e rrethuar nga një oborr që shërben si sipërfaqe funksionale dhe i përket pasurisë nr 1/471 Zk 8598, me SIP=406.5 m² truall.
- Vlera dysheme e qirasë mujore llogaritet në bazë të VKM-së Nr 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, dhe del si më poshtë:
Sip ndërteses ka çmimin e qirase mujore **100 l/m²**
Sip funksionale përreth ndërteses, sipas VKM-së së mësipërme ka çmimin sa 1/5 e qirase së objektit, ose 20% të saj, dmth **20 l/m²**.
- Nga llogaritjet del: Sipërfaqe ndërtese 165.5 m² x 100 L/m² = **16550 lekë**.
Për sipërfaqen funksionale llogaritjet bëhen me 20% të vlerës së qirasë së objektit:
Sip prej 406.5 m² x 20 L/m² = **8130 lekë**.
Në total, çmimi dysheme i qirasë mujore është; 16 550 + 8 130 = **24 680 L/Muaj**.
Ndersa çmimi dysheme i qirasë vjetore del: 24 680 x 12 = **296 160 lek/vit**.

Hartuesit e Raportit Teknik

Jurist: Armand Filipi



P/sek Aseteve; Ndoc Baqli



KRYETARI

MARK BABANI

NE MUNGESHE DHE ME URDHER

ZV/KRYETARI

LESTINË NDOJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. _____ Prot.,

Vau Dejës, më: _____.____.2021

RELACION

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë, z.Mark BABANI

Bazuar në Urdhërin Nr 80, Datë 01.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë “Për verifikimin dhe konstatimin e gjendjes faktike, funksionale të objektit të ish Qendrës Shëndetësore në Qytetin Vau Dejës dhe përcaktimin e saktë të sipërfaqes Ndërtesë + Truall”, nga verifikimi i gjendjes faktike dhe matjet e kryera në terren rezulton se:

Objekti i ish Qendrës Shëndetësore Vau Dejës, me Nr pasurie 1/54, Zk 8598, është pronë e Bashkisë, është i lirë nga çdo funksion që prej transferimit të stafit dhe të gjitha paisjeve nga aty, në Qendrën e re Shëndetësore të qytetit.

Objekti është në gjendje të mirë teknike për ushtrim veprimtarie në fushën e biznesit.

Nga matjet e kryera nga grupi i punës rezulton se objekti ka një sipërfaqe prej 165.5 m2.

Përreth objektit ka një sipërfaqe trualli me nr pasurie 1/471 Zk 8598 prej 406.5 m2, që i shërben objektit për funksionet e tij, të pasqyruara këto edhe në plan rilevimin përkatës.

Koordinatat e sipërfaqes janë të pasqyruara në plan rilevim.

Bashkëngjitur; Plan Rilevimi, Kopje e fletës së inventarit për pasurinë nr 1/54, kopje e çertifikatës së pronësisë për pasurinë nr 1/471.

Grupi i punës:

Ndoc Baqli

Emanuel Mardoda

Devis Peci

Armand Filipi

Denada Dodaj

PLAN RILEVIMI

PERGATITI

Ing. Hamid ÇULIQ

Liçensa T. 0675/2 Dt. 10.04.2018

Data e përgatitjes. 01.03.2021

S= 572 m² Truall

S= 165.5 m² Ndertese

Sipas VKM Nr. 1423 Dt. 10.10.2008

Nr. Rendor. _____

ING. TOPOGRAF
HAMID ÇULIQ
NR LIÇENSE-0675/2

IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8598

NR PASURISE 1/471; 1/54-ND VOL __ FAQE __


SHKALA 1:500

INDEKSI I HARTES : L; D-5

ADRESA E PASURISE:

RRETHI: SHKODER -- LAC-VAU DEJES

PRONAR: BASHKIA VAU DEJES



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)



Identifikoi: Dhimitër Papa (Specialist)

Supervizor: Salvator Gaci (Pergj. i Seksionit Urbanistik)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Ded Deganj (Kryetari i Bashkise)

(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula) 0692677090

Bashkia : Vau i Dejës

Fusha e perdorimit te Prones: Shendetesi

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
	1	2	3	5	6	7	8	9	10	11
14	8598 L-D-5	1/54	Truall Ndertese	Qender Shendetsore Qyteti Vau i Dejës <i>ad. Airike Modhe</i>	400	190	Sherbim paresor	Ministria e Shendetsise	Drejtoria e Shendetit Publik Shkoder	
15	1466 K-34-64 245-A	385/8	Truall Ndertese	Qender Shendetsore Qyteti Vau i Dejës, Lagjia Deje	300	120	Sherbim paresor	Ministria e Shendetsise	Drejtoria e Shendetit Publik Shkoder	
16	1466 K-34-64 245-A	385/9	Truall Ndertese	Ambjente funksionale te qendres shendetsore Lagjia Deje	200	70	Ambjente sherbimi	Ministria e Shendetsise	Drejtoria e Shendetit Publik Shkoder	
17	2702 K-34-64 244-D	85/46	Truall Ndertese	Qender Shendetsore Mjede	2400	200	Sherbim paresor	Ministria e Shendetsise	Drejtoria e Shendetit Publik Shkoder	
18	2763 K-34-64 5-C	149/2	Truall Ndertese	Qender Shendetsore Naraç	400	90	Sherbim paresor	Ministria e Shendetsise	Drejtoria e Shendetit Publik Shkoder	

62